



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za žalbe i Predstavke

Anr. 01-2/2023

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Burim Ademi kryesues, Adnan Konushevi dhe Franciska Zhitija - Ymeri, anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje, paraqitur kundër vendimit me numër 01/592-2023 i datës 04.05.2023, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), lidhur me Certifikimin e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhje të Parakohshme për Kuvendin Komunal në Leposaviq, duke vepruar sipas udhëzimeve që kanë rezultuar nga aktvendimi AA.nr.17/2023 i datës 10.05.2023, i Gjykatës Supreme të Kosovës, panelit në seancën jo publike të mbajtur me datë 12.05.2023, mori këtë:

V E N D I M

Hudhet si i palejuar apeli Anr.01/2023 i datës 04.05.2023, i paraqitur nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, më të cilin ka kërkuar që të anulohet vendimi me numër 01/592-2023 i datës 04.05.2023, i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), dhe të detyrohet KQZ-ja, që të bëjë certifikimin e 15 kandidatëve për kuvend komunal nga lista e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje, në Zgjedhjet e Parakohshme në Komunën e Leposaviqit, të mbajtura me 23 Prill 2023.

A r s y e t i m

Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje me datën 04.05.2023 ka paraqitur apel në PZAP-i me seli në Prishtinë, duke kontestuar vendimin me nr.01/592-2023 të datës 04.05.2023, të lëshuar nga KQZ-ja, lidhur me certifikimin e rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin Komunal të Komunës së Leposaviqit, të mbajtura më 23 prill 2023. Ku me këtë vendim KQZ-ja ka bërë certifikimin e vetëm 12 kandidatëve të Subjektit Politik LVV, e jo të 15 kandidatëve të cilët janë certifikuar për zgjedhjet e 23 prillit 2023.

Me këtë vendim KQZ-ja ka bërë certifikimin e vetëm 12 kandidatëve të Subjektit Politik LVV, e jo të 15 kandidatëve të cilët janë certifikuar për zgjedhjet e 23 prillit 2023.

Subjekti Politik LVV, në apelin e tij ka shtuar se vendimi me nr.01/592-2023, të datës 04.05.2023, e lëshuar nga KQZ-ja, është i gabuar dhe i kundërligjshëm në lidhje me çështjen e certifikimit të mandateve të fituara dhe kandidatëve të subjekteve politike, siç thuhet në vendim se KQZ-ja, nuk mund të certifikoj kandidatët që nuk kanë marrë asnjë votë, pra kanë

fituar zero vota, me propozim për PZAP-in, dhe ka propozuar që apeli të aprovohet dhe të anulohet vendimi i KQZ-së, si dhe të urdhëroj KQZ-ën për certifikimin e 15 kandidateve nga lista e subjektit politik LVV.

Në procedurë ankimore, Gjykata Supreme e Kosovës, me aktvendimin AA.nr.17/2021 të datës 10.05.2023, ka aprovuar ankesën e Subjektit Politik LVV, ka anuluar vendimin e lartë përmendur të PZAP-it, A.nr.01/2023 i datës 05.05.2023, dhe çështjen e ka kthyer në rivendosje në PZAP.

Me rastin e rivendosjes sipas ankesës së lartë përmendur të ankuesit Subjekti Politik LVV, duke vepruar në tërësi sipas vërejtjeve të dhëna nga Gjykata Supreme e Kosovës, në aktvendimin e lartë përmendur AA.nr.17/2021 i datës 10.05.2023, në procedurë të rivendosjes, PZAP-i vlerësoi lejueshmërinë e apelit të parashtruar nga Subjekti lëndor dhe vlerësoj se Apeli është i palejuar

Paneli ka vlerësuar se dispozitat ligjore të Ligjit për Zgjedhjet Lokale dhe as Dispozitat ligjore të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, konkretisht neni 122, nuk përcakton të drejtën e ankimimit të subjektit pas certifikimit të rezultatit zgjedhor, përkatësisht asnjë nga rregullat zgjedhore nuk lejon parashtrimin e ankimimit kundër vendimit për certifikimin të rezultateve zgjedhore, sepse rezultatet certifikohen pas përfundimit të gjitha procedurave, në QNR, Procedurat e ankimimit në PZAP dhe procedurat e ankimimit në Gjykatën Supreme, dhe pas kësaj certifikohen rezultatet ku nuk është i lejuar ankimimi sepse përfundon si proces zgjedhor siç rezulton në rastin konkret.

Prandaj nga arsyet e theksuara më lart si dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 118 par.1 të LZP-së, si dhe nenit 12 par.3 të Rregullores Nr.01/23 të PZAP-it, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.1-2/2023 me datën 12.05.2023

Kryesues i Panelit

Burim Ademi

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.